



POS Manual Përdorimi.

Versioni 1.1

Janar 2021.

Përmbajtja.

Një vështrim i përgjithshëm mbi sistemin.	3
Rreth këtij manuali.	4
1. Hapja e eBiznes.	8
2. Hyrja në llogari.	10
2.1 Hyrja si një punonjës.	11
2.2 Vërtetimi me dy faktorë (2FA).	12
2.3 Harrova fjalëkalimin.	13
2.4 Regjistro çertifikatën e kompanisë.	14
3. Ndërfaqja e përdoruesit.	20
3.1 Menuja.	20
3.2 Butonat, fushat e shkrimit dhe ikonat.	22
4. Arka.	25
4.1 Nisja e arkës (arka aktuale) .	25
4.2 Arka Aktuale.	26
4.3 Depozitim/Tërheqje.	27
4.4 Përfundo arkën.	29
4.5 Historia e arkës.	30
4.6 Raporti i arkës (mbyll arkën).	32
5. Artikujt.	35
5.1 Të gjithë artikujt.	36
5.2 Fshi artikullin.	36
5.3 Artikull i ri.	38
5.3.1 Kategoritë.	39
5.3.2 Barkodi.	39
5.3.4 Variacion i ri.	41
5.3.5 Një shembull i një artikulli me dy variacione.	42
5.3.6 Shtimi i TVSH.	43
5.3.7 Shtimi i përbërësve ekstra.	43
5.3.8 Shtimi i uljes.	45
5.4 Krijimi i një kategorie të re.	45
5.5 Përbërësit e rinj ekstra.	47
5.6 Krijoni një ulje të re.	47
5.7 Krijimi i një njësie të re matëse.	49
5.8 Fshirja.	49
6. Shitjet.	52
6.1 Kërkimi për një artikull në ekranin e shitjeve.	54
6.2 Pamja e rrjetës dhe pamja me kuti.	55

6.3 Pamja e artikullit (detaje mbi artikullin).	56
6.4 Shitja e një artikulli të painventarizuar.	58
6.5 Shtimi i një artikulli me çmim variabël.	58
6.6 Shporta.	60
6.6.1 Butoni me tre pika.	62
6.7. Porosi të hapura (të ruajtura).	63
6.8 Ruajtja e një porosie.	63
6.9 Pagesa.	65
6.9.1 Pagesa e suksesshme.	67
7. Transaksionet.	69
7.1 Detajet e transaksionit.	71
7.2 Rimbursimi.	72
8. Evente fiskalizimi.	75
8.1 Sinkronizimi i eventeve.	76
9. Punonjësit (Përdoruesit).	79
9.1 Statuset e përdoruesve.	80
9.2 Ndryshimi i statuseve.	80
9.3 Krijimi i një përdoruesi të ri.	81
9.4 Detajet e Punonjësve.	82
10. Konfigurimet.	84
10.1 Taksat.	86
10.2 Gjuhët.	88
10.3 Ndryshimi i fjalëkalimit kur jeni brenda sistemit.	88
10.4 Printerat.	90
10.5 Tingulli dhe dridhja.	91
10.6 Vendndodhjet.	91
10.7 Regjistrimi i vendndodhjeve.	92
10.8 Kasat.	94
10.9 Aktivizimi i një kase të re.	95
10.10 Shtimi dhe heqja e një punonjësi nga arka.	97
10.11 Çaktivizimi dhe fshirja e një arkë.	99



Një vështrim i përgjithshëm mbi sistemin.

Fiskalizim në kohë reale

Kjo zgjidhje ofrohet si një SaaS (software si servis), cloud-native, e ndërtuar mbi arkitekturën e AWS (Amazon Web Services). Për këtë arsye, sistemi mundëson kosto të ulët dhe siguri. Sistemi i ri i mundëson çdo qytetari të verifikojë menjëherë pas lëshimit të kuponit, nëse ajo është raportuar në sistemin tatimor qendror.

ebiznes do të krijojë një mekanizëm eficient të mbikqyrjes në kohë reale, me funksionalitete që përshijnë: operacione për administruesin, procesimin e pagesave, analizë të thelluar të të dhënave tatimore dhe modernizim të biznesit.

Çdo veprim në sistem bazohet në rrjedhë logjike dhe merr parasysh ambientin dinamik në pikat e shitjes, së bashku me gabimet njerëzore tek to. Përdoruesit i ofrohet një interface miqësore, me mundësi për veprime të shpetja dhe të lehta që minimizojnë humbjen e kohës.

Rreth këtij manuali.

Ky manual parashton dhe shpjegon funksionalitetet dhe operacionet e sistemit POS ebiznes. Figurat dhe veprimet e përfshira në të janë kryer nga një llogari admin, e cila ka akses të plotë mbi sistemin.

Kapitulli 1:

Si të hapni eBiznes.

Kapitulli 2:

Hyrja në ebiznes dhe regjistrimi i çertifikatës.

Kapitulli 3:

Ndërfaqja e përdoruesit dhe legjenda.

Kapitulli 4:

Arka dhe funksionalitetet e saj.

Kapitulli 5:

Artikujt dhe funksionalitetet e tyre.

Kapitulli 6:

Shitjet dhe funksionalitetet e tyre.

Kapitulli 7:

Transaksionet (porositë) dhe gjithë funksionalitetet e lidhura me to.

Kapitulli 8:

Eventet e Fiskalizimit dhe sinkronizimi i tyre.

Kapitulli 9:

Punonjësit (Përdoruesit).

Kapitulli 10:

Konfigurimet.



Historiku i ndryshimeve në dokument.

Versioni 1.0 - Tetor 2020.

Versioni 1.1 - Janar 2021.






01

Hapja e eBiznes.

1. Hapja e eBiznes.

Për të aktivizuar shërbimin e eBiznes, paraqituni në një nga dyqanet Vodafone dhe regjistroni kredencialet e biznesit tuaj.





02

**Hyrja në eBiznes
dhe regjistrimi i
çertifikatës.**

2. Hyrja në llogari.

Pasi të regjistroheni si përdorues (nëpërmjet dyqaneve Vodafone ose nëse jeni një punonjës i regjistruar nga administratori), mund të hyni në llogari duke vendosur emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Nëse dilni nga llogaria dhe hyni përsëri, email-i i fundit që keni përdorur do ju shfaqet si mjet lehtësues.

 Hyr

Hyr në llogarinë tënde

Emri i përdoruesit*

Fjalëkalimi*

Hyr

Harrova fjalëkalimin

 Hyr

Hyr në llogarinë tënde

Emri i përdoruesit*

user@emai.com



Fjalëkalimi*

Hyr

Harrova fjalëkalimin

2.1 Hyrja si një punonjës.

Nëse jeni një përdorues punonjës i regjistruar nga administratori brenda platformës, atëherë duhet të vendosni emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin që ju kanë ardhur në email. Pas konfirmimit, mund të ndryshoni fjalëkalimin (për privatësi personale) dhe të finalizoni procesin e regjistrimit.

 Hyr

Hyr në llogarinë tënde

Emri i përdoruesit*

Vendos emrin e përdoruesit

Fjalëkalimi*

Vendos fjalëkalimin

Hyr

Harrova fjalëkalimin

Hapi 1

 Hyr

Vendos fjalëkalimin tënd

Fjalëkalimi

Vendos fjalëkalimin

Konfirmo fjalëkalimin

Vendos fjalëkalimin, përsëri

Ruaj

Hapi 2

2.2 Vërtetimi me dy faktorë (2FA).

Vërtetimi me dy faktorë (2FA) është një mjet sigurie që ndihmon në mbrojtjen e llogarive nga hyrja e paautorizuar. Kjo realizohet nga një kod konfirmimi që duhet të vendosni përpara se të hyni në llogari.

 Hyr

Hyr në llogarinë tënde

Emri i përdoruesit*

Vendos emrin e përdoruesit

Fjalëkalimi*

Vendos fjalëkalimin

Hyr

Harrova fjalëkalimin

 Hyr

Konfirmo hyrjen

Kodi i konfirmimit*

Vendos kodin e konfirmimit

Konfirmo

Ridërgo kodinKthehu te hyrja

Hyrja në llogari

2FA

2.3 Harrova fjalëkalimin.

Nëse nuk e mbani mend fjalëkalimin, për të rivendosur fjalëkalimin, mjafton të vendosni emrin tuaj të përdoruesit. Sistemi do ju dërgojë një kod konfirmimi në adresën tuaj të emailit. Më pas, duhet të vendosni kodin e konfirmimit dhe fjalëkalimin e ri për të ruajtur ndryshimet.

 Harrova fjalëkalimin

Rivendos fjalëkalimin tënd

Emri i përdoruesit*

Dërgo

[Kthehu te hyrja](#)

Hapi 1

 Harrova fjalëkalimin

Rivendos fjalëkalimin tënd

Kodi I konfirmimit*

Fjalëkalimi*


Ruaj

[Kthehu te hyrja](#)


Hapi 2

2.4 Regjistro çertifikatën e kompanisë.

Në mënyrë që të keni akses në modulet dhe funksionalitetet e eBiznes, fillimisht duhet të regjistroni çertifikatën e kompanisë. Klikoni mbi "Shko tek çertifikata" dhe tek Konfigurimet, klikoni elementin e fundit të titulluar "Çertifikata".




Hapi 1



Hapi 2

Çertifikata e kompanisë mund të regjistrohet lehtësisht duke vendosur detajet e: **NIPT, ID personale, Email dhe Numrin e telefonit.**

Mund të ngarkoni çertifikatën duke zgjedhur një skedar dhe më pas klikoni "Regjistro".



Hapi 1

A screenshot of the 'Regjistro çertifikatën' screen. It shows a form with the following fields: NIPT (L123456678AL), ID personale (CN444444444L), Email (anadoe@gmail.com), and Telefon (+355 12 345 6789). Below the form, there is a section 'Ngarko çertifikatën' with a button 'Zgjidh skedar' and a text 'Skedari duhet të jetë .p12 or .pfx.' Below this is a file upload area with a blue arrow icon and a text 'Fjalëkalimi i çertifikatës' with an eye icon. At the bottom is a grey button labeled 'Regjistro'.

Hapi 2

A screenshot of the 'Regjistro çertifikatën' screen. It shows the same form as in Hapi 2, but with the file upload area filled with 'certificate.pfx' and a checkmark icon. The password field 'Fjalëkalimi i çertifikatës' is now filled with asterisks. At the bottom is a red button labeled 'Regjistro' with a hand cursor pointing to it.

Hapi 3

Për të përmbyllur verifikimin me dy hapa, vendosni kodin që ju dërgohet me SMS për të mbaruar procesin e regjistrimit.

Gjithashtu, keni mundësinë të rinovoni çertifikatën në çdo moment.

Mjafton të klikoni "Modifiko çertifikatën" dhe të ndryshoni të dhënat.

< Regjistro çertifikatën

Konfirmo

Të kemi dërguar një kod 5-shifror në SMS.

Vendos kodin

2

2

2

2

2

[Ridërgo kodin](#)

Mbaro

Hapi 4

< Çertifikata

Modifiko çertifikatën


Ju mund ta rinovoni çertifikatën në cdo kohë.

Informacioni mbi çertifikatën.



Emri i organizatës	John Doe
Email	admin@email.com
NIPT	L123456678AL
ID personale	CN4444444444L
Telefon	+355 12 345 6789
Data e fillimit	05/01/2021 09:30 AM
Data e skadencës	05/01/2022 09:30 AM
Vendndodhje	Tirane, Albania
Lëshuesi	NAIS Class 3 Certification Authority
Subjekti	Enerta Allko Fiskalizimi1

Hapi 5

Nëse proçesi juaj i regjistrimit nuk është i suksesshëm, mund të provoni të regjistroni çertifikatën përsëri duke klikuar: "Provo përsëri".



Nëse çertifikata juaj nuk është ende e vlefshme ose ka skaduar, do ju shfaqet një nga këto mesazhe:





03

**Ndërfaqja e
përdoruesit dhe
legjenda.**

3. Ndërfaqja e përdoruesit.

Ekrani i parë që hapet pasi hyni në sistem është "Shitje".

3.1 Menuja.

Menuja mund të aksesohet duke bërë "swipe" nga e djathta sapo hyni në sistem. Struktura është organizuar në mënyrë të tillë që të përmbajë të gjithë komponentet e Ebiznes, të cilat shpjegohen më në detaje përgjatë këtij manuali.

- Në cepin e majtë sipër, shfaqen emri i kompanisë dhe përdoruesit.
- Në cepin e majtë poshtë, shfaqet opsioni për të dalë nga sistemi.

Mund të aksesoni secilin element duke klikuar mbi të: Shitje, Artikujt, Transaksionet, Evente fiskalizimi, Arka, Përdoruesit dhe Konfigurimet.

Emri I kompanisë

John Doe



Shitje



Artikujt



Transaksionet



Evente fiskalizimi



Arka



Përdoruesit



Konfigurimet



24/7 Suport



Dil

3.2 Butonat, fushat e shkrimit dhe ikonat.

Të gjithë elementët bazë të cilët ju shërbejnë të navigoni sistemin, përfshihen këtu.

Butonat

Butonat primar



Butonat sekondar



Butona lundrues.



Fushat e shkrimit

Vendosja e fjalëkalimit

Tekst

tekst ndihmues

Etiketë

Teksti i futur

tekst ndihmues

Etiketë

Teksti i futur

tekst ndihmues

Fjalëkalimi

●●●●●●●●



tekst ndihmues

Vendos kodin

2

2

2

2

2



04

Arka

4. Arka.

Në ekranin e arkës mund të aksesoni:

- **Arkën aktuale.**
- **Historikun e arkës.**

Arka hapet në fillim e ditës suaj të punës (me sasinë e parave në nisje) dhe mbyllet në fundin e ditës.



4.1 Nisja e arkës (arka aktuale) .

Mund të nisni një arkë duke vendosur shumën e parave në nisje (shumën me të cilën po nisni ditën) dhe duke klikuar butonin nis.

×

Arka aktuale

Nis arkën

Para në nisje
250.00

ALL

Nis

4.2 Arka Aktuale.

Të gjitha informacionet e nevojshme për arkën tuaj aktuale përfshihen në këtë ekran. Detajet tregojnë:

- **ID** - Një ID unike e gjeneruar nga GOV.
- **Data e nisjes** - Data dhe orari kur është nisur arka.
- **Nisur nga** - Emaili i përdoruesit që ka hapur arkën.
- **Gjendje fillestare parash** - Shuma e parave fillestare që janë depozituar në arkë.
- **Depozituar/Tërhequr** - Sa është shuma e parave që janë depozituar/tërhequr, të cilat nuk janë të lidhura me shitjet.
- **Shuma e shitjeve me para në dorë dhe rimbursimeve me para në dorë.**
 - **Priten në arkë** - Llogaritet shuma e parave që duhet të jetë në arkë, duke marrë parasysh të gjitha detajet e mësipërme.

Gjithashtu, mund të vendosni një përshkrim për detaje shtesë mbi arkën.

<

Arka Aktuale

Përfundo arkën

Depozitim/Tërheqje

Detajet e arkës aktuale

ID	5b917ef5-8924-47ec-a508-938eab926573
Data e nisjes	15/10/2020 10:00 AM
Nisur nga	johndoe@gmail.com
Gjendje fillestare parash	250.00 ALL
Depozituar/Tërhequr	0.00 ALL >
Shitje me para në dorë	0.00 ALL >
Rimbursim me para në dorë	0.00 ALL >
Priten në arkë	250.00 ALL

4.3 Depozitim/Tërheqje.

Nëse përdoruesi kërkon të kryej depozitime ose tërheqje parash në arkë, të cilat nuk janë të lidhura me shitjet (pa u kryer shitje), ky veprim mund të regjistrohet në këtë ekran.

- **Shuma**- Vendosni shumën që do të depozitoni ose tërhiqni.
- **Përshkrimi** - Vendosni një përshkrim mbi arsyen e këtij veprimi.

Klikoni butonin "Depozito" ose "Tërhiq" në varësi të veprimit.

Gjithashtu, këtu kemi dy skedarë: "Depozituar" dhe "Tërhequr", të cilët përmbajnë informacion për transaksionet përkatëse gjatë ditës. Secili transaksion i depozituar/tërhequr ka:

- ID - Një ID unike e gjeneruar nga GOV.
- Orari- Orari kur është bërë depozitimi/tërheqja.
- Kryer nga - Emaili i përdoruesit që ka kryer depozitimin/tërheqjen.
- Sa është shuma e parave që janë depozituar/tërhequr (në varësi të cilit skedar jeni).

Në fund të ekranit kemi totalin e gjithë transaksioneve të depozituara/tërhequra.

Për të kaluar nga skedari "Depozituar" në "Tërhequr", mjafton të bëni "Swipe".

✕ Depozitim/Tërheqje

Shuma

50.00

ALL

Përshkrimi

0/15

Depozito

Tërhiq

Depozituar

Tërhequr

Tetor 15, 2020

Depozituar 20:00 PM

5b917ef5-8924-47ec-a508-938eab...
Pagesë

320.00 ALL

johndoe@gmail.com

Depozituar 20:25 PM

5b917ef5-8924-47ec-a508-938eab...
Pagesë

50.00 ALL

johndoe@gmail.com

Totali Depozituar

370.00 ALL

4.4 Përfundo arkën.

Një përdorues mund të perfundojë arkën në fundin e ditës së punës.

Shënim:

Përfundimi i arkës dhe mbyllja e arkës janë dy veprime të ndryshme. Vetëm mbyllja e arkës (që mund të kryhet si veprim vetëm nga përdoruesi me rolin admin) regjistron vlerën me të cilën është mbyllur arka.

Për të lexuar më shumë mbi mbylljen e një arke, kaloni në sektorin 4.6

Për të përfunduar një arkë, mbushni fushat përkatëse mbi sa është:

Gjendja e arkës (shuma që arka përmban aktualisht). Përshkrim mbi të. Nëse ka ndryshim vlerash mbi sa priten të jenë në arkë dhe gjendja që është realisht, arsyet mund të shënohen këtu, së bashku me detaje shtesë.

Priten në arkë është një fushë që tregon sa duhet të jetë shuma në arkë. Klikoni “Përfundo Arkën” për të finalizuar veprimin. Detajet e arkës aktuale përmbajnë:

- ID - Një ID unike e gjeneruar nga GOV. Data e nisjes - Data dhe orari kur është nisur arka.
- Nisur nga - Emaili i përdoruesit që ka nisur arkën.
- Gjendje fillestare parash - Shuma e parave fillestare që janë depozituar në arkë.
- Depozituar/Tërhequr - Sa është shuma e parave që janë depozituar/tërhequr, të cilat nuk janë të lidhura me shitjet.
- Shuma e shitjeve me para në dorë dhe rimbursimeve me para në dorë.
- Priten në arkë - Llogaritet shuma e parave që duhet të jetë në arkë, duke marrë parasysh të gjitha detajet e mësipërme.

✗ Përfundo arkën

Priten në arkë

265.00

ALL

Gjendja e arkës

265.00

ALL

Përshkrimi

Detajet e arkës aktuale

ID

5b917ef5-8924-47ec-a508-938eab926573

Data e nisjes

15/10/2020 10:00 AM

Nisur nga

johndoe@gmail.com

Gjendje fillestare parash

250.00 ALL

Depozituar/Tërhequr

50.00 ALL >

Shitje me para në dorë

240.00 ALL >

Rimbursim me para në dorë

25.00 ALL >

Priten në arkë

265.00 ALL

4.5 Historia e arkës.

Të gjithë veprimet e kryera mbi arkën mbahen në këtë ekran. Informacioni ndahet sipas tre skedarëve:

- **Arka të hapura** - Të gjitha arkat të cilat akoma nuk janë përfunduar.
- **Arka të përfunduara** - Të gjitha arkat të cilat janë përfunduar por nuk janë mbyllur ende nga përdoruesi me rolin admin. Vetëm përdoruesi me rolin admin mund të mbylli një arkë.
- **Arka të mbyllura** - Të gjitha arkat të cilat janë mbyllur nga përdoruesi me rolin admin.

Secila njësi arke përmban:

- Orarin.
- Emailin e përdoruesit që ka kryer veprimin.

Të dhënat mund të filtrohen gjithashtu sipas datës për një kërkim më të shpejtë.

 Historia e arkës

 Kërko për arkë

Arka të hapura

Arka të përfunduara

Arka të mbyllura

Tet 15, 2020

09:00 AM

user@gmail.com



Tet 5, 2020

02:00 AM

user@gmail.com



15:30 PM

user@gmail.com



10:00 AM

user@gmail.com



4.6 Raporti i arkës (mbyll arkën).

Në raportin e arkës mund të shihet sasia e parave që keni në arkë (gjendja e arkës) dhe diferenca (nëse ka) ndërmjet gjendjes dhe sasisë që duhet të ishte.

Një përdorues me rolin admin mund të mbylli arkën, nëse ajo është përfunduar paraprakisht.

Poshtë butonit "Mbyll arkën" ka detaje mbi:

- ID - Një ID unike e gjeneruar nga GOV.
- Data e nisjes - Data dhe orari kur është nisur arka.
- Nisur nga - Emaili i përdoruesit që ka nisur arkën.
- Përfunduar - Data dhe orari kur është përfunduar arka.
- Përfunduar nga - Emaili i përdoruesit që ka përfunduar arkën.
- Depozituar/Tërhequr - Sa është shuma e parave që janë depozituar/tërhequr, të cilat nuk janë të lidhura me shitjet.
- Shuma e shitjeve me para në dorë dhe rimbursimeve me para në dorë.
- Gjendje fillestare parash - Sa ishte gjendja fillestare e depozituar. Priten në
- arkë - Llogaritet shuma e parave që duhet të jetë në arkë, duke marrë parasysh të gjitha detajet e mësipërme.

×

Raporti i arkës

Gjendja e arkës

265.00

ALL

Diferenca

0.00

Mbyll arkën

ID

5b917ef5-8924-47ec-a508-938eab926573

Data e nisjes

15/10/2020 10:00 AM

Nisur nga

johndoe@gmail.com

Përfunduar

15/10/2020 20:00 PM

Përfunduar nga

johndoe@gmail.com

Depozituar/Tërhequr

50.00 ALL >

Shitje me para në dorë

240.00 ALL >

Rimbursim me para në dorë

25.00 ALL >

Gjendje fillestare parash

250.00 ALL

Priten në arkë

265.00 ALL




05

Artikujt

5. Artikujt.

Artikujt përmbajnë elementet e mëposhtme:

- **Të gjithë artikujt** - Të gjithë rekordet e artikujve që keni krijuar.
- **Kategoritë** - Grupet e artikujve me karakteristika të ngjashme.
- **Përbërës ekstra** - Nëse kërkonit të vendosni përbërës ekstra për produktet tuaja (shumë i dobishëm për produktet ushqimore).
- **Uljet** - Ditore, sezonale, të personalizuar.
- **Njësitë** - Njësitë matëse që përmban sistemi juaj.



5.1 Të gjithë artikujt.

Kur klikoni mbi "Të gjithë artikujt", do ju shfaqet një listë me të gjithë artikujt që keni krijuar.




Sipër butonit "Krijo artikull", mund të kërkonti për artikuj specifik ose t'i skanoni nëpërmjet barkodit.

Secila njësi artikulli përmban:

- Një fotografi/pamje;
- Një përshkrim të shkurtër mbi artikullin;
- Çmimin e artikullit.

5.2 Fshi artikullin.

Për të fshirë një artikull, mjafton të beni "swipe" në të djathtë të tij.



Bëni "swipe" mbi artikullin nga e djathta në të majtë për ta fshirë.

5.3 Artikull i ri.

Kur të krijoni një artikull të ri, keni tre sektorë me informacione mbi të:

- **Detaje artikulli**, ku duhet të vendosni të gjitha detajet e artikullit të nevojshme;
- **Përbërës ekstra**, nëse kërkon të vendosni përbërës ekstra për produktet tuaja (shumë i dobishëm për produktet ushqimore).
- **Uljet**, ku mund të aplikoni opsionet tuaja për ulje sipas dëshirës.

Në sektorin e "Detaje artikulli" duhet të vendosni: emrin, kategorinë dhe barkodin e tij (me skanim ose shkrim manual).

Më poshtë duhet të plotësoni informacion mbi: çmimin, njësinë dhe të shtoni një variacion nëse dëshironi.

Variacioni, i cili shpjegohet më gjerë në sektorin 5.3.4, përfshin variacione të ndryshme të së njëjtit artikull. Një artikull mund të ketë variacione të ndryshme të cilat ndikojnë edhe në çmimet e tyre (psh. molla e kuqe, e verdhë, jeshile).

Shtohen detajet mbi TVSH dhe përshkrimin e artikullit dhe ruhen ndryshimet.

Artikull i ri







Detaje Artikulli

Përbërës Ekstra

Uljet

Emri i artikullit
Burger

Kategori

Barkod

Çmim dhe inventar

Çmimi300.00Lek

Njësia

+ Shto variacion

TVSH

Përshkrimi
Dy tipe burger: me pule dhe me djath.

Ruaj

38

5.3.1 Kategoritë.

Mund të zgjidhni një kategori ose të krijoni një të re për artikullin tuaj. Për të krijuar një kategori të re, kaloni në sektorin 5.4.


Kategoritë		
Kërko për kategori...		
+ Krijo kategori		
FF	Fast Food	☒
Fr	Fruta	☐
Pe	Perime	☐
DFA	Drithëra, fasule dhe arra	☐

5.3.2 Barkodi.

Për të vendosur barkodin e artikullit mund të:

- Skanoni artikullin.
- Ta shkruani barkodin manualisht.

Barkod



Mbyll

Barkod

8690256010106 

5.3.4 Variacion i ri.

Një artikull mund të ketë variacione të ndryshme të cilat ndikojnë edhe në çmimet e tyre (psh. molla e kuqe, e verdhë, jeshile). Mund të shtoni një ose disa variacione për të.

Në këtë ekran mund të shtoni një variacion të ri dhe të përfshini informacionet e tij mbi:

- Emrin e artikullit që do shtohet si variacion;
- Çmimin;

Klikoni "U krye" për finalizim veprimi.

✕ Variacion i ri

Emri i artikullit

Cheese Burger

Çmim dhe inventar

Çmimi

400.00

Lek

U krye

5.3.5 Një shembull i një artikulli me dy variacione.

Variacionet	
I rregullt	300.00 ALL
Cheese Burger	400.00 ALL
+ Shto variacion	

5.3.6 Shtimi i TVSH.

Një artikull duhet të ketë gjithmonë të përfshirë një opsion TVSH-je. Në fillim keni një vlerë të paracaktuar, të cilën mund ta ndryshoni sipas dëshirës. Gjithashtu, duhet të zgjidhni nëse taksa do jetë "Përfshirëse" apo "Shtesë", pra do përfshihet në çmimin e artikullit apo do shtohet mbi çmimin e tij.

< Të gjitha taksat

20%☒

6%☐

0%☐

Ju mund të vendosni nëse taksa do të shtohet tek çmimi apo do të përfshihet në çmimin e artikullit.

përfshirëse☒

shtesë☐




5.3.7 Shtimi i përbërësve ekstra.

Për të shtuar përbërës ekstra për artikujt tuaj (shumë i dobishëm për produktet ushqimore), do të përdorni këtë ekran.

Mund të zgjidhni një ose disa përbërës ekstra ndaj artikullit tuaj.

Gjatë shitjes, mund të zgjidhni nëse doni t'i aplikoni ose jo këto përbërës shtesë, në varësi të preferencave të blerësit tuaj


Për të mësuar si të krijoni një përbërës ekstra nga fillimi, kaloni në sektorin 5.6.



5.3.8 Shtimi i uljes.

Një artikull mund të ketë një ose disa ulje në të njëjtën kohë (kjo për të akomoduar klientin, për arsye sezonale etj). Këtu mund të aplikoni një ose disa ulje.

Për të mësuar si të krijoni një ulje nga fillimi, kaloni në sektorin 5.6



5.4 Krijimi i një kategorie të re.

Mund të krijoni një kategori shumë lehtë duke vendosur emrin e saj dhe duke zgjedhur një ngjyrë "definuese" për të. Klikoni "Ruaj" për t'a finalizuar.

✕ Kategori e re



Emri
Fast Food

Ruaj

Zgjidh një ngjyre



5.5 Përbërësit e rinj ekstra.

Në këtë ekran mund të krijoni përbërës ekstra të rinj. Mund të shtoni disa përbërës ekstra duke klikuar "Shto të ri".

×

Përbërës të rinj ekstra

Emri

Salcat

Përbërësit ekstra

+ Shto të ri

Përbërës ekstra

0 ALL

Majonezë

50 ALL

Duhet të shtoni të paktën një përbërës ekstra.

Ruaj

5.6 Krijo një ulje të re.

Në këtë ekran mund të krijoni një ulje të re të personalizuar.

- 1.Vendosni emrin dhe vlerën.
- 2.Vendosni si dëshironi të aplikohet: me **përqindje** ose me një **vlerë monedhe**. Kikoni "Ruaj".

✕ Ulje e re

Emri
Black Friday

Vlera
20%

%

\$

Ruaj

5.7 Krijimi i një njësie të re matëse.

Këtu mund të krijoni një njësi të re për artikullin tuaj. Vendosi emrin e njësisë, shkurtimin që do shfaqet anës artikullit dhe precizionin që do ketë si njësi pas presjes.




5.8 Fshirja.

Këtu ju tregohet se si mund të fshini një element të caktuar brenda ekranit të artikujve. Veprimi mund të kryhet shumë thjesht duke bërë "swipe", siç përshkruhet edhe në fotografi.

Mund të fshini:

- Artikujt
- Kategoritë
- Përbërësit ekstra
- Uljet
- Njësitë matëse
- Variacione

Shënim i rëndësishëm: Nuk mund të fshini një kategori, përbërës ekstra, njësi matëse, ulje, variacion nëse janë të aplikuar mbi ndonjë nga artikujt që keni.



Bëni "Swipe" nga e djathta në të majtë për të fshirë.



06

Shitjet.

6. Shitjet.

Për të bërë procesin e shitjeve më të lehtë dhe të shpejtë, ky ekran përfshin të gjithë elementët e rëndësishëm për të: kërkuar, shtuar dhe shitur artikuj.

Sipas rradhës, përbëhet nga:

- Fusha për kërkimin e një artikulli.
- Ikona e skanimit të barkodit. Ajo shërben për të kërkuar një artikull duke e skanuar. Për të mësuar më shumë mbi këtë proces, kaloni në sektorin 6.1.
- Butoni me tre pika, i shpjeguar më gjerë në sektorin 6.6.1.

Për të kaluar nga një kategori artikulli në tjetrën, mjafton të bëni "swipe".

Shto një artikull jo inventari. Ky opsion ju lejon të shisni produkte, të cilat nuk i keni të regjistruara në sistem (në magazinë). Mund të lexoni më shumë për të në sektorin 6.4

Në menunë e poshtme, nën listën e artikuve keni:


- **Ikonën e porosive të hapura.** Po të klikoni mbi të, do ju dërgoj në porositë e hapura, të shpjeguara në sektorin 6.7.
- **Ikonën e shportës.** Po të klikoni mbi të, do ju dërgoj në shportë, të shpjeguar në sektorin 6.6.
- **Butonin "Paguaj".** Tregon shumën totale që blerësi juaj duhet të paguaj.

Shënim i rëndësishëm:

- Nëse klikoni mbi një artikull, ai shtohet në shportë. Mund të klikoni mbi të sa herë të dëshironi, në varësi të sasisë së artikullit që doni të keni.
- Nëse klikoni mbi një artikull, ama e mbani të shtypur (nuk e lëshoni gishtin pasi të klikoni), do ju dërgoj tek detajet e tij, në sektorin 6.3.
- Nëse zgjidhni të shtoni në shportë një artikull që ka çmim variabël, fillimisht duhet t'i shtoni çmimin, më pas mund ta vendosni në shportë. Shkoni tek sektori 6.5.
- Nëse një artikull ka disa variacione, duhet të zgjidhni një prej tyre përpara se ta vendosni në shportë.

Shto një
artikull jo
inventari

Porosi të
hapura



Skanoni
Barkodin



Shporta


6.1 Kërkimi për një artikull në ekranin e shitjeve.

Keni dy opsione:

- Duke kërkuar sipas emrit të artikullit.
- Duke kërkuar sipas barkodit të artikullit (që mund të bëhet duke klikuar ikonën e skanimit të barkodit).


Nëse e skanoni artikullin dhe ai nuk gjendet, sistemi do ju shfaqë mesazhin e mëposhtëm:





6.2 Pamja e rrjetës dhe pamja me kuti.

Pamja e rrjetës - i jep secilit artikull një pamje të njëjtë, ku detajet e artikujve bëhen më të dukshme. Për të aktivizuar këtë pamje, mjafton të klikoni butonin me tre pika dhe të shtypni "Pamje rrjet". Pamja me kuti - artikujt marrin pamje akoma më të madhe në ekran dhe vijnë në rresht njëri pas tjetrit.



6.3 Pamja e artikullit (detaje mbi artikullin).

Nëse klikoni mbi një artikull dhe e mbani të shtypur (pa e lëshuar gishtin), sistemi ju dërgoj në këtë ekran, i cili përfshin:

Butonat “+” dhe “-” me të cilët mund të rrisni ose zvogëloni sasinë e artikullit.

- **Rreth artikullit**, që përfshin një përshkrim mbi artikullin.
- Mund të zgjidhni **variacionin** e artikullit.
- Shtimi i **uljes** (nëse artikulli ka ulje).
- Shtimi i **përbërësve** ekstra (nëse ka).
- Shtimi i **TVSH** (i detyrueshëm).

Klikoni butonin "Shto në shportë" për ta shtuar artikullin në shportë

< Burger



1



300.00 ALL

Rreth artikullit

Një hamburger është një sanduiç i përbërë nga një ose më shumë i gatuar patties e mishit të bluar, zakonisht viçi, të vendosura brenda një feta rrotull bukë ose simite. Patty mund të jetë i skuqur në tigan, i pjekur në skarë, i tymosur ose flakë.

Zgjidh variacionin

I rregullt

300.00 ALL ☒

Cheese Burger

400.00 ALL ☐

Salcat (Zgjidh deri në 2)

Majonezë

50.00 ALL ☐

Ketch Up

50.00 ALL ☒

Shto ulje

Client Discount

5%



+ Shto ulje

Taksa e aplikuar

20%

shtuese



Shto në shportë

Sasia

Variacione

Ulje

Përshkrimi

Përbërës
ekstra

TVSH

6.4 Shitja e një artikulli të painventarizuar.

Kur klikoni "Shto një artikull jo inventari", sistemi ju dërgon në këtë ekran. Mjafon të shkruani emrin e artikullit dhe çmimin e tij për ta shtuar në shportë.

✗ Shit një artikull të painventarizuar

Emri artikullit

Çmimi

 Shto në shportë

6.5 Shtimi i një artikulli me çmim variabël.

